

**VENDIM**  
**Nr. 84, datë 5.2.2025**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 1497, DATË 19.11.2008, TË KËSHILLIT  
TË MINISTRAVE, “PËR SHTYPJEN E LETRAVE ME VLERË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr. 1497, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për shtypjen e letrave me vlerë”, të ndryshuar, në pikën 2.1, pas fjalëve “... shoqëria “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a., ...” shtohen “... , vetë ose nëpërmjet një shoqërie të krijuar prej saj, ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe shoqëria “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**